



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 13, dt. 15.03.2024

MBI NJË SHITESË NË REGJISTRIN E PROKURIMEVE TË VITIT 2024

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar, Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 25 datë 22.12.2023" Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

- Të miratojë copëtimin e zërit "Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve" dhe të shtojë në regjistrin e prokurimeve të vitit 2024 zërin si më poshtë :
 - Pakësim fondi
00/10430/01/602 462132 lekë (Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve)
 - Shtese fondi
00/10430/01/602 462132 leke (Shërbim përkujdesjeje dhe pastrimi për qendrën ditore të moshës të tretë Prill-Dhjetor 2024)
- Shërbim përkujdesjeje dhe pastrimi për qendrën e moshës të tretë do të shtohet si zë regjistrit të prokurimeve për vitin 2024
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Erjon NEXHIPI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi: O.Beqiraj
Juristi: Gj.Kristo
Sekretari: B.Mucc





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI NJË SHITESË NË REGJISTRIN E PROKURIMEVE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxheto: në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2024 si dhe të Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 25 datë 22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2024” ju paraqesim për miratim copëtimin e zërit “Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve” të miratuar në mbledhjen e muajit Dhjetor 2023 dhe shtimin në regjistrin e prokurimeve të vitit 2024 të zërit “Shërbim përkujdesjeje dhe pastrimi për qëndrën ditore të moshës të tretë Prill-Dhjetor 2024” si më poshtë :

- a. Pakësim fondi
00/10430/01/602 462132 lekë (Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve)
- b. Shtese fondi
00/10430/01/602 462132 leke (Shërbim përkujdesjeje dhe pastrimi për qëndrën ditore të moshës të tretë Prill-Dhjetor 2024)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet shkresës nr 807/3 datë 12.02.2024 na njofton se Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave për Financimin e Ofrimit të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, ka miratuar mbështetjen financiare për ofrimin e Shërbimeve Ditore Komunitare për Moshën e Tretë në Bashkitë e Qarkut Korçë nga Fondacioni “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim”. Vlera e miratuar për 11 muaj për periudhën (shkurt- dhjetor 2024) është 8,985,900 lekë, për paga dhe sigurime shoqërore, me një strukturë të përcaktuar punonjësish.

Gjithashtu , me miratimin e buxhetit të vitit 2024 në muajin Dhjetor 2023, Këshilli I Qarkut ka miratuar një fond për projekte sociale për moshat e treta dhe femijet e komuniteteve.

Bashkia Korçë ofron shërbime të përkujdesit shoqëror për të moshuarit nëpërmjet katër qëndrave ditore. Projektpropozimi I miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbulon tre sanitarë për katër qëndra. Në këto kushte nevojitet një punonjës shtesë që do të ofrojë shërbimin e kujdestarit dhe pastrimit në një nga qëndrat. Këshilli i Qarkut mund ti mbështesë ato në këtë drejtim nëpërmjet prokurimit të këtij shërbimi për qëndrën ditore të moshës të tretë. Për sa më sipër i kërkojmë Keshillit të miratojë shtimin në regjistrin e prokurimeve të zërit “Shërbim përkujdesjeje dhe pastrimi për qëndrën ditore të moshës të tretë Prill-Dhjetor 2024. Vlera totale e përlllogaritur për ofrimin e këtij shërbimi është 462132 lekë, për periudhën Prill-Dhjetor 2024.

Oljona Beqiraj
P.Finance